



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësua  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.1075/2021

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësua (PZAP)**, i përbërë nga gjyqtaret: Burim Ademi kryesues Zyhdi Haziri dhe Ferki Xhaferi anëtar, duke vendosur përkitazi me apelin e kandidates për anëtare të Kuvendit Komunal në Komunën e Prizrenit Elona Hoxha nga Subjekti Politik Partia Demokratike e Kosovës, me seli në Prishtinë, dega në Prizren, paraqitur kundër vendimit me numër 2948-2021 i datës 03.11.2021, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për Shpalljen e Rezultateve Përfundimtare për Zgjedhjet Lokale 2021, për Kuvendin Komunal, në seancën e panelit të mbajtur më datë 07.11.2021, mori këtë:

## V E N D I M

**Refuzohet** i pabazuar apeli Anr.1075/2021 i datës 04.11.2021, paraqitur nga kandidatja për anëtare të Kuvendit Komunal në Komunën e Prizrenit Elona Hoxha nga Subjekti Politik Partia Demokratike e Kosovës, me seli në Prishtinë, dega në Prizren me të cilën ka kërkuar rinumërimin e votave në Qendrat e Votimit: QV 2033 fshati Zhur, QV 2026 fshati Hoqa e Qytetit, QV 2071 fshati Kobaj, QV 2029 fshati Nashec, QV 2039 fshati Atmaxhë, QV 2026 Bajram Curr, QV 2002 Arbanë, QV 2013 Lubizhdë, QV 2006A, QV 2006X, QV 2042, QV 2005X, QV 2001, QV 2009, QV 2004, QV 2007, QV 2008, QV 2003 dhe QV 2055 në Prizren.

## A r s y e t i m

PZAP-i, ka pranuar një apel me datën 04.11.2021 nga kandidatja për anëtare të Kuvendit Komunal në Komunën e Prizrenit Elona Hoxha nga Subjekti Politik Partia Demokratike e Kosovës, me seli në Prishtinë, dega në Prizren me të cilën ka kërkuar rinumërimin e votave në Qendrat e Votimit: QV 2033 fshati Zhur, QV 2026 fshati Hoqa e Qytetit, QV 2071 fshati Kobaj, QV 2029 fshati Nashec, QV 2039 fshati Atmaxhë, QV 2026 Bajram Curr, QV 2002 Arbanë, QV 2013 Lubizhdë, QV 2006A, QV 2006X, QV 2042, QV 2005X, QV 2001, QV 2009, QV 2004, QV 2007, QV 2008, QV 2003 dhe QV 2055 në Prizren, me arsyen se pretendon se në këto qendra të votimit ka pasur parregullsi dhe keqpërdorime të votave.

PZAP-i, pas shqyrtimit të apelit, vlerësimit të pretendimeve ankimore, dhe në kuptim të nenit 105 paragrafi 1, dhe nenit 117 paragrafët 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

### **Apeli është i pa bazuar**

Nga shkresat e lëndës, rezulton kandidati kandidatja për anëtare të Kuvendit Komunal në Komunën e Prizrenit Elona Hoxha nga Subjekti Politik Partia Demokratike e Kosovës, me seli

në Prishtinë, dega në Prizren ka paraqitur apel me të cilën ka kërkuar rinumërimin e votave në Qendrat e Votimit të lartcekura.

Paneli, vlerëson se parashtuesi i apelit në mbështetje të pretendimeve të tij, nuk ka ofruar asnjë dëshmi lidhur me shkeljet e supozuara, edhe pse në kuptim të nenit 117 paragrafi 3 të LZP-së, barra e të provuarit bie mbi ankuesin, në rastin konkret paneli, nuk mundi të konstatoj se ka pasur manipulime gjatë numërimit të votave për kandidat të këtij subjekti politik, ashtu siç pretendon ankuesi, për faktin se thëniet e tij nuk mbështetën në asnjë provë konkrete por janë vetëm thënie ne apel, gjë që pritjet e ankuesit për të marrë më shumë vota automatikisht nuk nënkupton se ka mospërputhje të rezultatit si dhe llogaritja matematikore nga ana e ankuesit nuk argumenton shkeljet e pretenduara në apel.

Andaj, nisur nga arsyet e theksuara më lartë e në kuptim të neneve 115 paragrafi 1, 117 dhe 118 paragrafi 1 të LZP-së, paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

### **Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**

**Anr.1075/2021 më datën 07.11.2021**



**Kryesues i Panelit  
Burim Ademi**

***Këshilla Juridike:*** Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas Nenit 118 par.4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimet të këtij vendimi.